



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 qershor 2017
Nr. ref.:AGJ 1092/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI34/17

Parashtrues

Valdete Daka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të
Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Valdete Daka (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson avokati Artan Qerkini nga Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” me qendër në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), KGJK nr. 50/2017 të 6 marsit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartcekur të KGJK-së, me të cilin, sipas parashtrueses së kërkesës janë shkëlur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesja kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë dekretimin e z. Enver Peci në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme në pritje të vendimit të Gjykatës lidhur me kërkesën.
5. Parashtruesja gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të caktojë seancë dëgjimore në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 29, 54, 55 dhe 56 (1) (3) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 16 mars 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu Krasniqi.
9. Më 17 mars 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.
10. Gjykata ftoi KGJK-në të paraqesë komentet e saj, nëse ka, deri më 23 mars 2017.
11. Më 23 mars 2017, KGJK-ja dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.
12. Më 23 mars 2017, komentet e KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua që të paraqesë vërejtje shtesë deri më 5 prill 2017.
13. Më 27 mars 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Kolegjit shqyrtues vendosjen e masës së përkohshme, që ishte aprovuar nga Kolegji shqyrtues.

14. Të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri ta miratojë masën e përkohshme deri më 16 maj 2017.
15. Më 31 mars 2017, parashtruesja e plotësoi kërkesën e saj me ankesa shtesë.
16. Më 3 prill 2017, Gjykata e përcolli parashtruesën e parashtrueses në KGJK dhe i ftoi ata të paraqesin komentet e tyre, nëse kanë, deri më 7 prill 2017.
17. Më 7 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj lidhur me plotësimin e kërkesës, si dhe disa komente shtesë.
18. Më 12 prill 2017, komentet shtesë të KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua të paraqesë ndonjë koment deri më 18 prill 2017.
19. Të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga KGJK-ja që të dorëzojë, jo më vonë se më 18 prill 2017 si në vijim: (i). Procesverbalin e mbledhjes së KGJK-së kur u votuan kandidatët për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; (ii). Dokumente tjera relevante të cilat KGJK-ja i konsideroi të kenë lidhje me tërë procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; dhe (iii). Sqarimi i kritereve për vlerësimin e meritave të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
20. Më 18 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj përfundimtare dhe dokumentet e kërkuara në Gjykatë.
21. Më 2 maj 2017, Gjykata vendosi njëzëri të vazhdojë masën e përkohshme deri më 16 qershor 2017.
22. Më 1 qershor 2017, Gjykata aprovoi pranueshmërinë e kërkesës me shumicë dhe votoi me shumicë gjetjen e shkeljes.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 08 dhjetor 2016, KGJK-ja mori Vendimin KGJK nr. 152/2016 për shpalljen e pozitës së lirë të punës për Kryetar të Gjykatës Supreme.
24. Më 23 dhjetor 2016, ishte shpallur konkursi për këtë pozitë. Parashtruesja e kërkesës aplikoi në këtë konkurs dhe u regjistrua në rrethin e vlerësimit të kandidatëve.
25. Më 13 janar 2017, KGJK-ja caktoi Komisionin për Vlerësim dhe Intervistim për të shqyrtuar kandidatët.
26. Më 13 shkurt 2017, janë mbajtur intervistat dhe Komisioni vlerësoi kandidatët si në vijim:

- | | | |
|----|---------------------|-----------|
| 1. | Valdete Daka | 90 pikë |
| 2. | Nesrin Lushta | 87.3 pikë |
| 3. | Enver Peci | 85 pikë |
| 4. | Erdogan Haxhibeqiri | 83 pikë |
27. Më 6 mars 2017, KGJK-ja, pas votimit të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, përfundoi si më poshtë:
- Në raundin e parë, znj. Valdete Daka u rendit e para në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte 5 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 4 ABSTENIME;
 - Në raundin e dytë, znj. Nesrin Lushta renditet e dyta në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte 2 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 4 ABSTENIME; dhe
 - Në raundin e tretë z. Enver Peci, i renditur i treti në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit të Vlerësimit, kishte 6 vota PËR dhe 4 ABSTENIME.
28. Më 6 mars 2017, KGJK-ja pas tri raundeve të votimit, me Vendimin e saj KGJK nr. 50/2017, zgjodhi z. Enver Peci që të emërohet Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe dërguan nominimin e tyre te Presidenti i Republikës së Kosovës për emërimin e tij me dekret.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 108.4 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], nenit 24.2 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].
30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *“Në procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ka pasur parregullsi të cilat reflektojnë në cenimin e të drejtave të parashtrueses të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe atë, inter alia, të drejtën e përcaktuar në nenin 45, sipas të cilit secili qytetarë i Republikës së Kosovës ka të drejtën aktive (të drejtën të zgjedhë) dhe të drejtën pasive të votës (të drejtën për t’u zgjedhur).”*
31. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vlerësojë *“a i është cenuar e drejta kushtetuese e garantuar me nenin 45, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si rezultat i zbatimit të gabuar të Rregullores së KGJK-së për përzgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës”.*
32. Parashtruesja e kërkesës deklaron se *“[...] nuk kërkon nga Gjykata Kushtetuese të deklarohet në lidhje me mënyrën e interpretimit të nenit 4 të Rregullores në fjalë...”, por ajo, “... kërkon të konstatojë se zbatimi i gabuar i saj, ka cenuar të drejtat kushtetuese të parashtrueses së kërkesës [...]”.*

33. Sipas parashtrueses së kërkesës bazuar në Rregulloren e përmendur më lart, KGJK-ja së pari votoi për kandidatin i cili ka pasur rezultatin më të mirë të vlerësimit, në rastin konkret, KGJK-ja ka votuar për të. Në atë votim, 5 (pesë) anëtarë votuan “PËR” zgjedhjen e saj, 4 (katër) anëtarë “ABSTENUAN”, ndërsa 1 (një) anëtar kishte votuar “KUNDËR”.
34. Në vijim ajo deklaroi se, *“sipas vlerësimit të KGJK-së kandidatja e parë nuk ka marrë shumicën e thjeshtë të votave, prandaj është vazhduar me procedurën e votimit për dy kandidatët e mbetur. Kandidati i renditur si i treti, z. Enver Peci, pas votimit të anëtarëve të KGJK-së ka marrë 6 vota “PËR” dhe 4 vota “KUNDËR”.*
35. Parashtruesja e kërkesës vlerëson se *“Përfundimisht sipas vlerësimit të KGJK-së z. Enver Peci është propozuar për përzgjedhje në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas mënyrës së përshkruar më lartë. Vlen të potencohet se lista për përzgjedhjen e kandidatëve ka karakter shterues, çka do të thotë se në rastin kur kandidati i parë merr shumicën e thjeshtë të votave, votimi përfundon dhe për kandidatët e tjerë nuk votohet fare”.*
36. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *“procedura e përzgjedhjes është përfshirë në shkelje të paragrafit 2 të nenit 8 të Rregullores Nr. 9/2016, të riformuluar me nenin 4 të Rregullores Nr. 14/2016 të KGJK-së”.*
37. Parashtruesja e kërkesës thekson se *“në asnjë rast abstenimi nuk mund të konsiderohet si votë negative apo kundër sepse atë efekt e ka vota KUNDËR dhe nuk mund të barazohet vota abstenim dhe kundër. Abstenimi nënkupton vullnetin e anëtarëve për ta krijuar kuorumin dhe mundësimin e zhvillimit të procedurës, për mos-pjesëmarrje në votim dhe pajtim me vendimin e anëtarëve tjerë.”*
38. Ajo më tutje vlerëson se *“fokusi duhet përqendruar te interpretimi juridik dhe logjik i shprehjes së vullnetit të KGJK-së si organ kolegjal i vendimmarrjes. Në rastin konkret, gjatë votimit 5 (pesë) anëtarë kanë shprehur vullnetin PËR përzgjedhjes së kandidatës ndërsa vetëm 1 (një) votë ka qenë KUNDËR, andaj duhet të shtrohet pyetja se mbi çfarë logjike është ardhur deri te konstatimi se KGJK ka shprehur vullnetin kundër kandidaturës së kandidatës Valdete Daka”.*
39. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, *“Në Vendimin e datës 6 mars 2017, KGJK nuk u pajtua me standardet kushtetuese për propozimin e gjyqtarëve në pozitën udhëheqëse në sistemin gjyqësor të Kosovës. Norma kushtetuese kërkon që emërimi, gjegjësisht propozimi i KGJK-së duhet të bëhet në bazë të meritës së kandidatëve, derisa Vendimi 50/2017 i KGJK-së nuk përmban asnjë arsytim pse z. Enver Peci ka meritat e mjaftueshme për t'u propozuar për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës edhe pa marrë parasysh faktin se në vendim thuhet se **ai ishte renditur i treti (3) në listën e kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme.** Nëse do të respektoheshin standardet kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve në pozita udhëheqëse, KGJK-ja duhet të ketë dhënë arsye të hollësishme mbi meritat e z. Enver Peci, i cili do të justifikonte propozimin e KGJK-së për dekretimin e tij në pozitën e lartpërmendur”.*

40. Parashtruesja e kërkesës më tej deklaroi se “me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk kanë zbatuar standardet e parapara në nenin 108.4 të Kushtetutës. Mund të vërehet qartë që Rregullorja 14/2016 e KGJK-së për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimin, Vlerësimin, Pezullimin dhe Shkarkimin të Kryetarëve të Gjykatave nuk i aplikon kërkesat sipas Kushtetutës. Në një situatë të tillë, duhet të marrim parasysh hierarkinë e akteve gjyqësore, ku Kushtetuta mbizotëron çdo akt tjetër ligjor që është në kundërshtim me të”.
41. Parashtruesja e kërkesës konsideron se “me rastin e propozimeve për dekretim të gjyqtarëve për rolet udhëheqëse, në bazë të dispozitave kushtetuese, KGJK-ja duhet të marrë parasysh se ky autoritet shtetëror do të ndihmojë dukshëm Presidentin e Republikës, para se të dekretojë kandidatin për Kryetar të Gjykatës Supreme, për të pasur një pasqyrë të qartë, një vlerësim të vërtetë dhe të ftohtë të meritave, kritere objektive dhe subjektive dhe në fund, që të sigurojë kandidaturën më të plotë, me një mbështetje të gjerë”.
42. Lidhur me çështjen e shterjes së mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës deklaroi se “Për të mbështetur qëndrimet juridike të shprehura më lartë parashtruesja e kërkesës i referohet Praktikës së Gjykatës Kushtetuese të krijuar nëpërmjet Aktgjykimit Nr. KI99/14 dhe KI100/4, Parashtrues Shyqri Sylja dhe Laura Pula, në të cilin Gjykata Kushtetuese në mes tjerash shprehet: “Megjithatë, Gjykata vëren se edhe në qoftë se ka mjete juridike. në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marr parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur. Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim”.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Parashtruesja kërkon vendosjen e masës së përkohshme në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 54 të Rregullores së punës.
44. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “zbatimi i vendimit të KGJK-së, që përmban në vete një mori shkeljesh të të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë, do të ishte në vetvete edhe një cenim i mëtutjeshëm i të drejtave të garantuara. Vet zbatimi i këtij vendimi antikushtetues do të privonte ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e funksionimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të gjitha vendimet e marra nën drejtimin e z. Enver Peci do të mund të shpallehin si të kundërligjshme, fakt ky i cili cenon parimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës. Nëse një aktgjykim në dobinë time nga Gjykata Kushtetuese do të qonte në zgjedhjen time për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, vendimet unifikuese të Gjykatës Supreme të marra nën drejtimin e z. Peci, e të cilat merren me qëllim të zbatimit unik të ligjeve, do të konsideroheshin si të pavlefshme”.

Komentet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

45. KGJK-ja “*thekson se kërkesa e parashtruar është e papranueshme për shkak të faktit se parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar për ngritjen e kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese.*
[...]
Vendimi i KGJK-së është një akt administrativ dhe si i tillë, një konflikt administrativ mund të ngrihet kundër tij në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Parashtruesja e kërkesës mund ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar ato”.
46. Në mbledhjen e 6 marsit 2017, pas votimit lidhur me këtë çështje, Këshilli Gjyqësor i Kosovës arriti në përfundimin si më poshtë: “...
 - Në raundin e parë, **znj. Valdete Daka** e renditur e para sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte **5 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 4 ABSTENIME**;
 - Në raundin e dytë, **znj. Nesrin Lushta** e renditur e dyta në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte **2 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 4 ABSTENIME**; dhe
 - Në raundin e tretë **z. Enver Peci**, i renditur i treti në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit të Vlerësimit, kishte **6 vota PËR dhe 4 ABSTENIME”.**
47. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 4 të Rregullores nr. 14/2016 për ndryshimin e nenit 8 të Rregullores 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Monitorues, KGJK-ja thekson që: “**VOTA E ABSTENIMIT** është një institut procedural që është përdorur nga pothuajse të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kur votojnë për raste të caktuara. Pretendimi se ky institut nuk rregullohet me ligj apo rregullore nuk do të konsiderohet si çështje kontestuese sepse nuk mund të gjejmë një rregullore të tillë për votimin **PËR** dhe **KUNDËR**. Si rregull, kjo çështje nuk është e rregulluar me vendosmëri nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por gjatë nxjerrjes së vendimeve ky institucion përdor vota **PËR**, **KUNDËR** dhe **ABSTENIM** dhe asnjë vendim nuk është kontestuar asnjëherë si rezultat i këtij votimi”.
48. Në përgjigje ndaj shkeljes së pretenduar të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, KGJK-ja konsideron se: “[...] kjo dispozitë ligjore është e detyrueshme për t'u zbatuar për të gjithë kandidatët, ku në këtë rast KGJK-ja në mënyrë të pavarur dhe të paanshme e ka zbatuar atë”.
49. KGJK-ja më tutje kërkon nga Gjykata të hedh poshtë kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme dhe për dëgjim publik.

50. KGJK-ja gjithashtu konsideron se “...në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk është i zbatueshëm standardi kushtetues nga neni 108, paragrafi 4 i Kushtetutës së Kosovës, me vetë zhvillimin e procedurës paraprake pranë Komisionit Vlerësues, i cili ka bërë vlerësimin edhe në bazë të meritave personale, konsiderojmë që në këtë proces është zbatuar edhe parimi i meritokracisë në këtë procedurë konkrete. Duhet pasur parasysh se KGJK-ja në cilësinë e organit kolegjal i cili sipas Kushtetutës përbëhet prej 13 anëtarëve, vendimmarrja në këtë organ kolektiv konsiston në diskrecionin e anëtarëve të këtij organi të cilin e shprehin përmes procesit të votimit duke u bazuar në procedurat të rregulluara sipas aktit të brendshëm të organit gjegjës por edhe sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës”.
51. Përveç kësaj, KGJK-ja deklaron se “[...] Neni 24.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se Askush nuk mund të diskriminohet në baza të gjinisë ...”, megjithatë kjo dispozitë nuk ka përcaktuar asnjë të drejt të asnjë personi që duke u thirur në një të drejt të tillë të krijoj rezultat pozitiv për veten e tij. Për më tepër nisur nga parimi i nenit 3, Barazia para ligjit konsiston në të drejtën e qytetarëve që të mos diskriminohen në kuptimin e gëzimit të të drejtave dhe lirive ku secili duhet të gëzoj mbrojtje të njëjtë me kushte të njëjta pa marr parasysh dallimet ndërmjet njerëzve”.
52. Në fund, KGJK-ja konsideron që “është evidente që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kryer ndonjë lëshim formal dhe procedural që do ta bënte procesin e propozimit të kandidatit më të përshtatshëm për pozitën e Gjykatës Supreme të Kosovës, të joadekuat, të pavlefshëm ose ligjërish të përshtatshëm”.

Komentet shtesë të parashtrueses së kërkesës

53. Parashtruesja e kërkesës ka komentuar se: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton së paku dy komponentë të cilët do të shërbejnë si udhëzues për KGJK-në në lidhje me propozimet e këtij institucioni që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve në pozitat udhëheqëse në gjyqësorin e Kosovës . Këta komponentë janë: **meritat e kandidatit** dhe barazia gjinore dhe etnike në mes të kandidatëve”.
54. Sa i përket arsytimit të Vendimit të KGJK-së lidhur me meritat e kandidatëve, parashtruesja e kërkesës komentoj se: “në Vendimin e datës 6 mars 2017, KGJK nuk veproi në pajtim me standardet kushtetuese për propozimin e gjyqtarëve në pozita udhëheqëse në sistemin gjyqësor të Kosovës. Norma kushtetuese kërkon që emërimi, gjegjësisht propozimi i KGJK-së duhet të bëhet në bazë të meritës së kandidatëve, derisa Vendimi 50/2017 i KGJK-së nuk përmban asnjë arsytim pse z. Enver Peci ka meritat e mjaftueshme për t'u propozuar për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës edhe pa marrë parasysh faktin se në vendim vërehet se **ai ishte renditur i treti (3) në listën e kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme**. Nëse do të respektoheshin standardet kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve në pozita udhëheqëse, KGJK duhet të ketë dhënë arsye të hollësishme mbi meritat e z. Enver Peci, i cili do të justifikonte propozimin e KGJK-së për dekretimin e tij në pozitën e lartpërmendur”.

55. Sa i përket respektimit të Kushtetutës nga KGJK-ja gjatë zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme, parashtruesja e kërkesës komentoï se: *“me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, [KGJK] nuk ka zbatuar standardet e parapara në nenin 108.4 të Kushtetutës. Mund të vërehet qartë që Rregullorja 14/2016 e KGJK-së për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave nuk i aplikon kërkesat sipas Kushtetutës. Në një situatë të tillë, duhet të marrim parasysh hierarkinë e akteve ligjore, ku Kushtetuta mbizotëron çdo akt tjetër ligjor që është në kundërshtim me të”*.
56. Sa i përket zbatimit të nenit 31 të Kushtetutës për rastin e saj, parashtruesja e kërkesës komentoï që: *“Dështimi për të aplikuar normat kushtetuese në emërimin e kandidatit për kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, bën që i gjithë procesi i zgjedhjes të jetë i pavlefshëm dhe i parregullt, neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, garanton [...] mbrojtje të barabartë të të drejtave, para gjykatave dhe autoriteteve tjera shtetërore, siç është në të vërtetë KGJK-ja. Prandaj, nuk ka dilemë që efektet e nenit 31 të Kushtetutës janë përtej procedurës gjyqësore”*.
57. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës i referohet Opinioni Nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) ku theksohet se procedurat për emërimin e kryetarëve të gjykatave duhet të ndjekin të njëjtën rrugë si ato të përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve duke marrë parasysh meritat dhe përvojën gjyqësore të kandidatëve.

Përgjigja e KGJK-së ndaj komenteve shtesë të dorëzuara nga parashtruesja e kërkesës

58. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës sipas nenit 108 (4) të Kushtetutës, KGJK komentoï se: *“Teksti kushtetues i sipërpërmendur krijon disa premisa të përgjithshme dhe standarde kushtetuese, mbi të cilat duhet të bazohen propozimet për emërimin e gjyqtarëve. Këto parime dhe standarde duhet të shërbejnë si parime udhëzuese gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve që do të emërohen në pozitat e larta gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vazhdimisht ka ofruar mbështetje dhe ka afirmuar këto standarde kushtetuese dhe janë këto standarde që kanë udhëhequr çdo proces të rekrutimit për pozita gjyqësore. Megjithatë, dispozita e lartpërmendur nuk i referohet fare procesit të propozimit ose emërimit të kandidatëve për pozitën e kryetarëve të gjykatave, dhe as për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës në veçanti”*.
59. KGJK-ja pohon që neni 103 (4) [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 22 [Emërimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës] të Ligjit (Nr. 03/L-223) për KGJK-në është respektuar plotësisht në procesin zgjedhor të Kryetarit të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë, KGJK-ja komentoï se: *“Në dritën e këtyre dy dispozitave ligjore përkatëse, ne konsiderojmë se duhet të ndërtohet një proces i tërë i propozimit dhe emërimit të kandidatëve për Kryetarin e Gjykatës Supreme. Sa i përket dispozitës së parë ligjore, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i referohet Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht nenit 103 (4) të saj, i cili përcakton që*

kandidati për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të jetë nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Përveç kësaj, paragrafi 2 i këtij neni përcakton si në vijim: “Kryetarët e Gjykatave emërohen nga Këshilli në konsultim me gjyqtarët e gjykatave përkatëse. Në emërimin e Kryetarëve të Gjykatave, Këshilli do të marrë në konsiderim trajnimin e specializuar menaxherial apo përvojën”. Nga dispozita ligjore në fjalë mund të shihet qartë se procesi i emërimit të gjyqtarëve të kryetarëve të gjykatave nuk është një proces i izoluar plotësisht i varur nga procesi i intervistimit ose testimit. Dispozita e lartpërmendur instalon një proces të konsultimit, nëpërmjet marrjes së mendimeve të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse kur propozon ose emëron këta kryetarë të gjykatave”.

60. Sa i përket vlerësimit të meritave të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, KGJK-ja, komentoi se: “[...] Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kryer me sukses obligimin e tij ligjor me dhënien e propozimeve për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Përveç kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas dhënies së propozimeve për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjithashtu ka marrë parasysh kërkesën e dytë ligjore, përkatësisht trajnimin e posaçëm menaxherial ose përvojën e punës. Për këtë qëllim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konsideroi se kandidati i propozuar ka specializimin e kërkuar dhe përvojën adekuate menaxheriale në mënyrë që të mbajë pozitën më të lartë gjyqësore në Kosovë”.
61. Sa i përket referencës së parashtrueses së kërkesës në Opinionin nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, KGJK-ja komentoi se: “Duke iu referuar referencës [...] në Opinionin nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë që shërben si organ i Këshillit të Evropës, organizatë anëtare e të cilit nuk është Republika e Kosovës, ne konsiderojmë si të pranueshëm dhe të qartë ekzistencën e këtyre standardeve të njohura ndërkombëtare në këtë fushë, por ato në asnjë mënyrë të drejtpërdrejtë nuk janë të zbatueshme në kontekstin specifik të Kosovës dhe për këtë arsye, përderisa dokumentet e tilla nuk përbëjnë një instrument të detyrueshëm sipas ligjeve pozitive, ne e konsiderojmë si të parëndësishme referencën e bërë ndaj këtyre standardeve”.
62. Përfundimisht, KGJK-ja parashtrroi se, në bazë të nenit 20 paragrafi 2 i Ligjit për KGJK-në (nr. 03 / L-223), gjyqtarët e Gjykatës Supreme janë konsultuar në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhanë mendime për secilin kandidat, si më poshtë:
 1. Znj. Valdete Daka 1 (një) mendim pozitiv;
 2. Znj. Nesrin Lushta 4 (katër) mendime pozitive;
 3. Z. Enver Peci 4 (katër) mendime pozitive;
 4. Z. Erdogan Haxhibeqiri 3 (tri) mendime pozitive.

Dispozitat relevante kushtetuese, ligjore dhe dispozita tjera

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

[...]

4. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.

Ligji Nr. 03 / L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Neni 22

Emërimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës

1. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës do të emërohet siç ceket në nenin 103 (4) të Kushtetutës.

Rregullorja nr. 14/2016 e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Neni 4

“Këshilli Gjyqësor voton në mënyrë të fshehtë dhe kandidati që merr shumicën e thjeshtë të votave konsiderohet si i përzgjedhur për pozitën e kryetarit të gjykatës”.

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ???

Neni 48

Votimi

“48.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit”.

Pikat 37 dhe 38 të Opinionit nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE)

“37. Mënyra e përzgjedhjes, emërimit ose zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave në shtetet anëtare varet nga përgjigjet e pyetësorit. Këto procedura ndikohen nga sistemi ekzistues i administratës gjyqësore dhe roli i kryetarëve të gjykatave. Në disa sisteme, kryetarët emërohen ose promovohen nga gjyqtarët, ndërsa të tjerët lejojnë që emërimet ose zgjedhjet të bëhen nga jashtë. Në rastin e parë, merren parasysh meritat e kandidatit, si dhe përvoja e tij/saj gjyqësore”.

“38. KKGJE konsideron se procedurat për emërimin e kryetarëve të gjykatave duhet të ndjekin të njëjtën rrugë si ato për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve. Kjo do të përfshijë një proces vlerësimi të kandidatëve dhe një organi që ka autoritetin për të zgjedhur dhe/ose

emëruar gjyqtarët në pajtim me standardet e vendosura në Rekomandimin CM/Rec (2010) 12 dhe Opinionet e mëparshme të KKGJE17”.

Vlerësimi i pranueshmërisë

63. Gjykata së pari do të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës i cili përcakton:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
65. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës.
66. Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin që:

*Neni 48
Saktësimi i kërkesës*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
Afatet*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.”

67. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parashihet:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.”

68. Sa i përket kërkesave të përcaktuara në nenin 113 (7) të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë të detyruar të shterojnë vetëm

- mjetet juridike që janë të qasshme, për të siguruar kompensim në lidhje me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. Prandaj, baza e mjetit juridik në të drejtën vendore duhet të jetë e qartë (Shih ndër të tjera Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 28 korrikut 1997, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, paragrafi 74)
69. Gjykata vëren se dispozitat e Ligjit në fuqi, Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk parashohin mjete juridike kundër vendimit të kontestuar nga parashtruesja e kërkesës.
 70. Gjykata vëren se KGJK-ja ka parashtruar se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka mundur të iniciojë konflikt administrativ dhe të përdorë mjetet juridike në dispozicion të saj sipas Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Sidoqoftë, KGJK-ja nuk e mbështeti atë pohim me praktikën gjyqësore përkatëse, në raste të krahasueshme, ku shihet se parashtruesja e kërkesës do të kishte perspektivë të arsyeshme për sukses në rast se ajo do të kishte zgjedhur të inicioje një konflikt administrativ.
 71. Sa i përket çështjes së shterjes së mjeteve juridike, në raste të krahasueshme, Gjykata përsërit gjetjet e saj në Aktgjykimin në rastet KI99/14 dhe KI100/14: *“Megjithatë. Gjykata vëren se. edhe ne qofte se ka mjete juridike në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marr parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shtjerrim”* (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI99/14 dhe KI100/14, Parashtrues të kërkesës Shyqyri Syla dhe Laura Pula, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes se Kryeprokurorit te Shtetit*, Aktgjykim i 8 korrikut 2014, në paragrafin 50).
 72. Për më tepër, në rastet në të cilat mjeti juridik i sugjeruar në të vërtetë nuk ofronte gjasa të arsyeshme për sukses, p.sh. nga pikëpamja e praktikës së vendosur gjyqësore vendore, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar atë nuk është pengesë për pranueshmëri (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI56/09, *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit të Komunës së Prizrenit*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, në paragrafin 45 me referenca të mëtejshme).
 73. Duke marrë parasysh specifikën e procedurës së zgjedhjeve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit se nuk ka mjet juridik që adreson në mënyrë efektive pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës.
 74. Sa i përket afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, Gjykata konsideron se, kur është e qartë që në fillim se parashtruesi i kërkesës nuk ka mjet juridik efektiv, periudha katër mujore fillon nga data e aktit për të cilin është bërë ankesa ose data në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte prekur drejtpërdrejt ose u bë i vetëdijshëm për një akt të tillë ose kishte njohuri për

efektet e tij të padëshiruara (*Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], § 157).

75. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses është dorëzuar në pajtim me afatin ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
76. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka specifikuar me saktësi se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, janë shkelur në dëmin e saj, me jokushtetutshmërinë e pretenduar të procedurave të votimit për nominimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme.
77. Pas ekzaminimit të ankesave dhe vëzhgimeve të parashtrueses së kërkesës, si dhe komenteve të KGJK-së, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Prandaj, kërkesa nuk mundet të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (Shih, për shembull, *Rasti A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55 dhe gjithashtu shih *mutatis mutandis* *Rasti nr. KI132/15, Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

Meritat e kërkesës

78. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], dhe 108. 4 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës.
79. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton se:
 - “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.
80. Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

81. Gjykata i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”

82. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 108 [Këshillit Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, i cili ndër të tjera përcakton se:

“1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t’u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

4. Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.

83. Gjykata vëren se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-a-vis* normave kushtetuese dhe se atë nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesja e kërkesës apo nga KGJK-ja (Shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO73/16, parashtruesi i kërkesës Avokati i Popullit, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative Nr. 1/2016 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës më 21 janar 2016*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 78 me referenca të mëtejshme).

84. Në lidhje me nenin 24 (1) të Kushtetutës, Gjykata rikujton që *“të gjithë janë të barabartë para ligjit”*. Gjykata konsideron se kjo nënkupton që parimet e

- përgjithshme të barazisë së trajtimit zbatohen për të gjitha veprimet e autoriteteve publike në marrëdhëniet e tyre me individët.
85. Ky parim është përcaktuar më saktësisht në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, i cili kërkon që të gjitha autoritetet publike në procedurat e tyre duhet të garantojnë mbrojtjen e barabartë të të drejtave të individëve.
 86. Për më tepër, Gjykata rikujton që neni 108 (1) i Kushtetutës e detyron KGJK-në të garantojë funksionimin e pavarur dhe të paanshëm të sistemit gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se cilësia e procedurave të vendimmarrjes brenda KGJK-së gjithashtu duhet të bazohet në parimet e pavarësisë dhe të paansisë, si parakusht për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë si tërësi.
 87. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që neni 108 (4) i Kushtetutës kërkon që propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bazohen, *inter alia*, në meritë të kandidatëve.
 88. Gjykata vëren se parimi i meritokracisë është i lidhur ngushtë me parimin e barazisë para ligjit, mbrojtjen e barabartë të të drejtave, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e hapjes.
 89. Në procesin e përzgjedhjes siç është zbatuar nga KGJK-ja, secili nga kandidatët për emërim si Kryetar i Gjykatës Supreme është vlerësuar sipas kriterëve të bazuara në meritë për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për këtë pozitë. Bazuar në informatat e dhëna në Gjykatë duket se katër kandidatët janë vlerësuar të kenë merita të mjaftueshme për këtë pozitë, duke qenë se secili nga kandidatët ka arritur një rezultat prej së paku 80 pikëve. Megjithëse as parashtruesja e kërkesës, dhe as KGJK-ja nuk kanë treguar domethënie të saktë të këtyre rezultateve, duke pasur parasysh se, në parim, të katër kandidatët u pranuan në procesin e votimit, Gjykata vëren se KGJK-ja konsideroi se secili prej kandidatëve ka merita të mjaftueshme për t'u kualifikuar për këtë pozitë.
 90. Si e tillë, çështja themelore në lidhje me meritat e secilit kandidat për t'u kualifikuar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk është një çështje që ka pasur qëllim të adresohet me votim, pasi kjo tashmë ishte adresuar në procesin e vlerësimit paraprak. Procesi i votimit kishte për qëllim të zgjidhte një kandidat nga katër kandidatët e kualifikuar mjaftueshëm.
 91. Gjykata rikujton se në procesin e votimit, aspekt themelor i parimit të “barazisë” është që çdo kandidat do të përfitojë nga “barazia e mundësive”. Kjo do të thotë që të gjithë kandidatët do të kenë mundësinë të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.
 92. Përveç kësaj, sipas “parimit të përgjithshëm të barazisë”, Gjykata duhet të vlerësojë në bazë të testit të proporcionalitetit nëse parashtruesja e kërkesës/kandidatët janë vënë në pozitë të barabartë gjatë procesit të votimit për zgjedhjen e kandidatit për nominim si Kryetar të Gjykatës Supreme.

93. Gjykata është në dijeni të lirisë së vlerësimit të KGJK-së në votimin e kandidatit që ata e konsiderojnë më të përshtatshëm për të marrë pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Megjithatë, kjo liri nuk është absolute dhe nuk mund të konsiderohet të jetë aq e gjerë sa të shpërfillë parimet e drejtësisë dhe barazisë në procesin e votimit.
94. Gjykata shqyrton “procedurat në tërësi”, që do të thotë se i tërë procesi i votimit shqyrtohet për nga respektimi i parimeve të barazisë dhe drejtësisë. Në këtë mënyrë, Gjykata rishikon cilësinë themelore të procesit të votimit në tërësinë e tij për sa i përket të gjithë kandidatëve, dhe jo vetëm sa i përket parashtrueses së kërkesës në mënyrë të veçantë. Gjykata konsideron se votimi nënkupton “zgjedhjen midis alternativave”, dhe abstenimi nënkupton “mos pjesëmarrje në procesin e votimit”.
95. Gjykata vëren se në procesin e votimit të zbatuar nga KGJK-ja, në fakt, nuk kishte zgjedhje midis alternativave, sepse secili kandidat u votua veçmas. Vetëm pas refuzimit të një kandidati, kandidati i ardhshëm merrej në konsiderim dhe votohej. Duke pasur parasysh se u përzgjedh kandidati i tretë që u votua, kandidati i katërt nuk u votua fare.
96. Përveç kësaj, në çdo raund të votimit, secili prej votuesve kishte pasur prapë mundësinë të votonte për ose kundër kandidatit që votohej. Në fakt, secili anëtar që voton i KGJK-së ka mundur të mos bëjë asnjë zgjedhje, sepse kur shikohet procedura e përgjithshme, bëhet e qartë se secili anëtarë që voton i KGJK-së ka mundur të votojë për të gjithë kandidatët, ose ka mundur të votojë kundër të gjithë kandidatëve.
97. Sa i përket abstenimit, Gjykata vëren se procesi mundësoi që anëtarët që votojnë të KGJK-së jo vetëm që kanë mundur ta bëjnë, por edhe abstenuan në mënyrë selektive; me fjalë të tjera, në vend që të abstenojnë nga pjesëmarrja në procesin e votimit në tërësi, anëtarët që votojnë të KGJK-së zgjedhën të marrin pjesë në votimin e një kandidati dhe të mos marrin pjesë në votimin e një kandidati tjetër, me sa duket në mënyrë arbitrare.
98. Përveç kësaj, Gjykata konsideron që edhe në rastet kur zbatohet vota e abstenimit, autoriteti publik ka për detyrë që në mënyrë të qartë të rregullojë kuptimin dhe vlerën e votës abstenuese. Dështimi në parashikimin e votës abstenuese dhe dështimi për të parashikuar efektin e saj në procesin e votimit krijon pasiguri juridike sepse pengon parimet e hapjes dhe parashikueshmërisë.
99. Në këto rrethana, Gjykata vëren se forma aktuale e rregullimit të procesit të votimit nuk u ofron “mundësi të barabarta” kandidatëve, sepse procesi nuk parasheh mekanizma mbrojtës procedural në lidhje me garantimin e trajtimit të barabartë.
100. Pabarazia nuk bazohet në ndonjë cilësi të veçantë të kandidatëve, por në procedurë substancialisht të padrejtë të votimit që u mundëson anëtarëve që votojnë të KGJK-së të votojnë shumë herë dhe të abstenojnë në mënyrë selektive për kandidat.

101. Pozita e lirë e Kryetarit të Gjykatës Supreme është vetëm një konkurs. Vetëm një nga kandidatët mund të emërohet në këtë pozitë. Secili votues duhet të jetë në gjendje të japë votën e vet për një kandidat, jo për dy, tre ose më shumë kandidatë. Procesi i votimit është një proces i vetëm, dhe secilit anëtar që voton i KGJK-së duhet t'i mundësohet ose të marrë pjesë ose të abstenojë - gjithçka ose asgjë.
102. Gjykata konsideron se procesi i votimit i kryer nga KGJK-ja përbën padrejtësi në procedurën e votimit sepse është e pamundur të dihet se kush është duke marrë pjesë në votim dhe kush jo. Në të njëjtën kohë është e pamundur të dihet se kush ka në fakt mbështetjen e shumicës së anëtarëve që votojnë të KGJK-së dhe kush nuk e ka.
103. Prandaj, Gjykata konsideron se pabarazia në procesin e votimit nuk siguron që të gjithë kandidatët të përfitojnë nga barazia para ligjit, siç garantohet me nenin 24 (1) të Kushtetutës, dhe nga mbrojtja e barabartë e të drejtave e garantuar me nenin 31 (1) të Kushtetutës. Si pasojë e këtyre pabarazive, Gjykata konsideron se KGJK-ja nuk ka vepruar në pajtueshmëri me detyrimet e saj kushtetuese për të siguruar pavarësi dhe paanshmëri të sistemit gjyqësor, dhe për të miratuar propozime për emërimë në sistemin gjyqësor në bazë të meritave, siç kërkohet me nenin 108, paragrafët 1 dhe 4 të Kushtetutës.
104. Në bazë të shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata konstaton se procesi i votimit për nominimin e kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme është i papajtueshëm me nenin 24 (1) [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës. Gjykata konsideron se procesi i votimit nuk ofron garanci të mjaftueshme procedurale për të mbrojtur barazinë e kandidatëve gjatë tij, dhe si i tillë, dëmton perceptimin publik për pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë të cilën KGJK-ja kërkohet ta sigurojë.
105. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se edhe forma e emërimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të konsiderohet të jetë në pajtim me parimet e hapjes, meritokracisë dhe parashikueshmërisë. Ajo ka ndikim në pavarësinë dhe paanshmërinë në tërë administratën e drejtësisë në Kosovë dhe ndikon në besimin që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 tetorit 2009, *Micallef kundër Maltës*, [DHM], kërkesa nr. 17056/06, paragrafi 99 dhe referencat e përmendura aty).
106. Prandaj, Gjykata konkludon se KGJK-ja duhet të mbajë proces të ri të votimit që nga kandidatët të zgjedhë kandidatin për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Ky votim i ri duhet të jetë në përputhje me konstatimet e kësaj Gjykate dhe në harmoni me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
107. Pasi konstatoi se procesi i votimit i kryer nga KGJK-ja në përzgjedhjen e kandidatit për Kryetar të Gjykatës Supreme nuk ishte në pajtim me nenet 24 (1) [Barazia para Ligjit] dhe 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, Gjykata e konsideron te panevojshme që ta shqyrtojë pretendimin e rastin e

parashtruesit në lidhje me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Kërkesa e parashtrueses për të mbajtur shqyrtim verbal

108. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për të mbajtur seancë verbale, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit, i cili, ndër të tjera, parasheh që:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës”.

109. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në këtë rast sipas formulimit të nenit 20 paragrafi 2 i Ligjit.

110. Prandaj, kërkesa e parashtrueses për të mbajtur seancë gojore refuzohet.

Përfundim

111. Në përfundim, Gjykata konstaton se mekanizmi i votimit i zbatuar nga KGJK-ja për kandidatët për emërimin e një kandidati në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, nuk ka parashikuar masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e mjaftueshëm të parimeve të barazisë, transparencës dhe hapjes dhe gjatë procesit të votimit. Si rezultat i këtij procesi të votimit të gabuar dhe jokohorent, të gjithë kandidatët për Kryetar të Gjykatës Supreme, duke përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës, ishin vendosur në një pozitë të pasigurisë juridike, pabarazisë dhe përzgjedhjes së pamerituar.

112. Gjykata vëren se nuk është detyrë e saj të spekulojë se cili kandidat është më i përshtatshëm për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Gjykata dëshiron të sigurohet se votimi dhe procesi i votimit janë në pajtim me Kushtetutën. Pajtueshmëria me standardet kushtetuese, *inter alia*, përfshin: (i) një proces të votimit i cili u garanton kandidatëve barazi, transparencë dhe hapje; (ii) koherencë logjike dhe lidhje në mes të procesit të votimit dhe përzgjedhjes së kandidatit të zgjedhur bazuar në zgjedhjen e shprehur në mënyrë demokratike të anëtarëve që votojnë të KGJK-së.

113. Gjykata rithekson se është në dijeni të lirisë së vlerësimit të KGJK-së në zgjedhjen e kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Megjithatë, kjo liri nuk është absolute dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë, që të jetë në kundërshtim me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenet 27, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1) dhe 63 (1) dhe (5) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2017

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, me shumicë votash, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të neneve 24 (1) [Barazia para Ligjit], 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës;
- III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës;
- IV. TË SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e KGJK Nr. 50/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 6 marsit 2017;
- V. TA URDHËROJË Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të mbajë proces të ri të votimit për përzgjedhje të kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme në pajtim me gjetjet në këtë Aktgjykim;
- VI. TA URDHËROJË Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, që të dorëzojë informata në Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi;
- VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;
- VIII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'i kumtohet Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Palëve;
- IX. TË PUBLIKOHET në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit në Gazetën Zyrtare.
- X. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi